

NJOFTIM PËR VEND TË LIRË PUNE

***Intesa Sanpaolo Bank Albania kërkon të punësojë:
Pozicioni: Specialist për Parandalimin e Pastrimit të Parave
Departamenti i Përputhshmërisë Rregulative dhe Parandalimit të Pastrimit të Parave***

Përgjegjësitë:

- Të kryejë investigime mbi transaksionet dhe aktivitetet e dyshimta për pastrim parash dhe financim terrorizmi;
- Të monitorojë, dhe kryejë analiza mbi, transaksionet e klientëve për identifikimin e indiceve, formave dhe zhvillimeve të rrezikut të pastrimit të parave/financimit të terrorizmit;
- Të ndihmojë në zhvillimin dhe implementimin e rregulloreve dhe politikave të parandalimit të pastrimit të parave dhe financimit të terrorizmit;
- Të kryejë trajnimet e stafit të Bankës dhe të mbështesë strukturat e Bankës (duke përfshirë por pa u kufizuar në strukturat e biznesit) në çështjet e parandalimit të pastrimit të parave dhe financimit të terrorizmit;
- Të monitorojë perditësimet e legjislacionit të parandalimit të pastrimit të parave, dhe të sigurojë përshtatjen me to, të politikave dhe rregulloreve të brendshme të Bankës;
- Të përgatisë dhe dërgojë raportimet pranë Agjencisë së Inteligjencës Financiare, sipas ligjit;

Kërkesat/afësitë:

- Diplomë Masteri në Financë, Ekonomik, Informatikë Biznesi, Juridik, apo në fusha të përngjashme me to;
- Minimumi 3 vjet përvojë në bankë apo institucion tjetër financiar ose kompani auditimi;
- E preferueshme (por jo e detyrueshme për aplikim) përvojë në fushën e parandalimit të pastrimit të parave;
- Aftësi shumë të mira analitike dhe investigative;
- Aftësi shumë të mira në Paketën Microsoft Office;
- Aftësi kompjuterike dhe kërkimore;
- Njohuri të shkëlqyera të gjuhës Angleze (të folur dhe të shkruar)
- Aftësi të shkëlqyera për të punuar në grup;
- Aftësi shumë të mira për të punuar në mënyrë të pavarur;

Aplikantët duhet të dorëzojnë një kopje të detajuar të CV-së në gjuhën angleze

Aplikimet duhet të dorëzohen jo më vonë se data **27 Korrik 2024** pranë Burimeve Njerëzore në adresën e email-it: recruiting@intesasanpaolobank.al